REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 501/26 Dt. 03.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13, 17 pika k dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, neni 34 paragrafi 1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, bazuar në kërkesën 01-030 nr. 133401 datë 27.10.2026 të Ajredin Berisha, për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin (pagesën) e shpenzimeve të sistemimit dhe banimit (strehimit) të Ajredin Berisha, me familje, nga Prizreni, të cilit iu është rrezikuar shtëpia dhe prona e tij për shkak të rrëshqitjes së dheut të shkaktuara nga punimet në rrugën Prizren-Tetovë, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të sigurimit të strehimit të përkohshëm (pagesa e qeras për banim), lejohen mjetet financiare në shumën 500.00 € (pesëqind euro) për muaj në kohëzgjatje për një 1 (vit).

2. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij Vendimit, do të alokohen në xhirollogarinë e qiradhënësit-konformë kontratës për qiradhënie.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.

4. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.